

**ORGANIZATA TURISTIKE
TË KOMUNËS SË MEDVEGJËS**

Nikolla Tesla pn, 16246, Banja e Sijarinës
Gjyre Jakshiq 4A, 16 240, Medvegjë
PIB: 105089062; Numri personal: 17683403
Xhirollogaria : 840-1124664-87
Numër:670/11
Data: 08.11.2023.viti
M e d v e g j ë

Në bazë të nenit 30. të Ligjit mbi Punën ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 24/2005, 61/2005, 54/2009, 32/2013, 75/2014, 13/2017 – vendimi i GJK dhe 113 /2017), neni 13. të Statutit të Organizatës turistike të Komunës së Medvegjës (Gazeta Zyrtare e Qytetit të Leskocit, Nr. 16/2023), Neni 67. paragrafi 6. të Ligjit për Mbrojtjen e natyrës ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 36/09), Rregullorja mbi kushtet të cilat duhet të përmbushen nga menaxhuesi i zonës së mbrojtur ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 85/2009), dhe Vendimi për Shpalljen e Monumentit të Natyrës. "Mrkonjski Vis" ("Gazeta zyrtare e qytetit të Leskovcit", nr. 8/2023), neni 7. të Vendimit mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe numrin e të punësuarve në Organizatën turistike të Komunës së Medvegjës (Nr. 242/05, 09.05.2023), Aktëvendimet e Kryetarit të Komunës së Medvegjës për miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Organizatën turistike të Komunës së Medvegjës. 07 numri: 113-3/2023 nga data 23. tetor 2023. Konkluzion i Komisionit për dhënie të pëlqimit për punësim të ri dhe angazhim në punë shtesë nga shfrytëzuesit e mjeteve publike 51 numër: 112-8682/2023 nga data 27.09.2023. drejtori i Organizatës turistike të Komunës së Medvegjës shpallë:

K O N K U R S

PËR PRANIMIN E PESË EKZEKUTUES NË MARDHËNIE PUNË NË KOHË TË PACAKTUAR NË ORGANIZATËN TURISTIKE TË KOMUNËS SË MEDVEGJËS

I. Për qëllim të plotësimit të vendit të punës ekzekutive të paplotësuar në Organizatën e Turizmit të Komunës së Medvegjës, SHPALLI KONKURSIN për pranim (5) pesë ekzekutues në kohë të pacaktuar.

II. Vendet e punës të cilat plotësohen: EKONOMIST I DIPLOMUAR PER PUNËT E KONTABILITETIT FINANCIAR-numri i ekzekutuesve 1(nje), BASHKËPUNUES PROFESIONAL PËR MBROJTJEN E NATYRËS - numri i i ekzekutuesve 2 (dy) dhe ROJTARI I ZONËS SË MBROJTUR-numri i ekzekutuesve 2 (dy)

III. Kushtet për pjesëmarrje në konkurs janë:

EKONOMIST I DIPLOMUAR PER PUNET E KONTABILITETI FINANCIAR - numri i ekzekutuesve 1 (nje)

- Përgatitja profesionale: Arsimi i lartë (për studimet bazë akademike të orientimit ekonomik, në masën prej të paktën 240 pikë ESPB, gjegjësisht studime profesionale të specializuara, sipas rregullores që rregullon arsimin e lartë duke filluar nga data 10. shtator 2005.

apo për studimet bazë që zgjasin të paktën katër vite, me orientim ekonomik, sipas rregullores që rregullon arsimin e lartë deri më 10 shtator 2005.),

- njohja e punës në kompjuter,
- të paktën një vit përvojë pune.

BASHKËPUNUES PROFESIONAL PËR MBROJTJEN E NATYRËS – numri i i ekzekutuesve 2 (dy)

Përgatitja profesionale: Për studime në vëllim e të paktën 240 pikave SEBP, të orientimit biologjik, pylltar, bujqësor, ekologjik, gjeografik apo turistik sipas rregullores, që rregullon arsimin e lartë duke filluar nga data 10. shtator 2005. apo në studimet themelore që zgjasin të paktën katër vite, sipas rregullores që rregullonte arsimin e lartë deri më 10. shtator 2005.

- përvojë pune të paktën një vit provoj pune në profesion
- njohja e punës në kompjuter,
- njohja e një gjuhe të huaj.

ROJTARI I ZONËS SË MBROJTUR - numri i ekzekutuesve 2 (dy)

- Përgatitja profesionale: arsimin e mesëm apo arsimin fillor,
- një vit përvojë pune,
- të ketë të kryer provimin profesional për përdorimin e armëve (nëse nuk e posedon në momentin e punësimit, duhet ta kryejë brenda 6 (gjashtë) muajve.

IV. Përveç kërkesave të veçanta, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet nga dispozitat e neneve të Ligjit mbi Punën.

- të jetë shtetas i Republikës së Serbisë,
- të jetë i moshës madhore,
- se nuk është dënuar për vepër penale me burgim të pakushtëzuar së paku 6 muaj që e bën të papërshtatshëm për të kryer punë në organet shtetërore.

V. Me aplikimin kandidati është i detyruar të bashkëngjisë edhe dëshmitë e mëposhtme:

1. Diploma e përgatitjes profesionale,
2. Certifikata e shtetësisë së RS,
3. Certifikata e lindjes,
4. Dokumentet që vërtetojnë përvojën e punës (vrtetimi, aktëvendimet dhe aktet tjera që tregojnë se në çfarë pune, me çfarë kualifikimi profesional dhe në çfarë periudhe është fituar përvoja e punës);
5. Vërtetim i aftësisë mjekësore, (vetëm për vendë pune rojtar i zonës së mbrojtur 2 (dy) ekzekutues.

6. Vërtetim nga organi kompetent se kandidati nuk është dënua për veprë penale me burgim të pakushtëzuar prej së paku 6 muaj, që e bën të papërshtatshëm për të kryer punë në organet shtetërore (lëshuar nga AP Leskovc).

7. Vërtetim nga organi kompetent se ndaj kandidatit nuk është ngritur asnjë hetim apo aktakuzë (jo më i vjetër se 6 muaj).

Të gjitha provat duhet të dorëzohen në origjinal apo në fotokopje të vërtetuara nga komuna apo gjykata apo nga një noter publik.

VI. Aplikimi në konkurs përmban: emrin dhe mbiemrin e kandidatit, datën dhe vendin e lindjes, adresën e banimit, të dhënat mbi arsimin, informatat për llojin dhe kohëzgjatjen e përvojës së punës me një përshkrim të shkurtër të vendeve të punës në të cilat ka punuar kandidati para se të dorëzojë aplikimin për konkur dhe përgjegjësitë në ato punë, të dhënat për zhvillimin profesional dhe të dhënat për fushat e veçanta të dijës.

VII. Më kandidatët, aplikimet e të cilëve janë me kohë, të lejueshme, të kuptueshme dhe të plota, të shoqëruara me të gjitha dëshmitë e nevojshme dhe që plotësojnë kushtet për të punuar në vendet e punës të shpallura, intervista do të bëhet në hapsira të Organizatës turistike të Komunës së Medvegjës me njoftim paraprak të kandidatit, në numrat e telefonit dhe adresat të cilat i paraqesin në aplikimet e tyre.

VIII. Aplikimi në konkurs me dokumentacion të plotë duhet të dërgohet në adresën: Organizata Turistike e Komunës së Medvegjës, - Drejtori, 16240 Medvegjë, Gjure Jakshiq 4A, me shënimin: "Për konkurs".

IX. Personi përgjegjës për ofrimin e njoftimeve rreth konkursit

- Miroslav Pavloviq, 064-9806822

Konkursi të shpallet në tabelën e shpalljeve.

X. Afati për paraqitjen e aplikimeve është 15 ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e ardhëshme nga shpallja në publikimin "Poslovi" dhe të njëjtën ditë do të publikohet të në tabelën e njoftimeve të Organizatës turistike të Komunës Medvegjë dhe në faqen e internetit të Organizatës turistike www.tomedvedja.org.rs. Njoftohen kandidatët se dokumentacioni do të kthehet vetëm me kërkesë me shkrim të kandidatit.

Vërejtje:

Aplikimet e parakohshme, të papranueshme, të pakuptueshme apo të paplota dhe aplikimet që nuk shoqërohen me të gjitha provat e nevojshme në origjinal apo fotokopje të vërtetuara nga komuna, gjykata apo nga noteri publik do të refuzohen.

* Të gjitha shprehjet, konceptet, emrat, mbiemrat dhe foljet në këtë konkurs që janë përdorur në gjininë gramatikore mashkullore, u referohen pa dikriminim dhe personave të gjinisë femërore.

